



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E GJAKOVËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ilir Abazi* udhëheqës i ekipit të auditimit, dhe anëtarit të ekipit *Arben Hundozi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Qeverisja e mirë.....	34
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	38
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	46
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	49

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Gjakovës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Gjakovës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë e blera në vitin 2018 në vlerë prej 531,690€ nuk ishin regjistruar në modulën e pasurisë në SIMFK. Komuna nuk ka arritë të regjistrojë as pronat dhe lokalet afariste në regjistrin e pasurisë në SMFK, dhe si rezultat vlera e pasurisë e shpalosur në pasqyrat vjetore financiare nuk ishte e plotë dhe e saktë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:****Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Gjakovës.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### **Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes**

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### **Baza për opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e pasurive e shpalosur në pasqyra financiare ishte e nënvlerësuar dhe nuk prezantonte gjendjen e plotë dhe e saktë të tyre.

Kjo ngase 11 pagesa për projekte kapitale në vlerë prej 531,690€ të realizuara në fund të vitit 2018 nuk ishin regjistruar në modulën e pasurisë të SIMFK-së. Po ashtu, ende një pjesë e pronave komunale dhe lokaleve afariste mbeten të pa regjistruara në regjistrin e pasurive.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Komuna është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente, dhe vlera e përafërt e tyre siç është prezantuar në PVF-të e vitit 2018 pritet të jetë rreth 1,600,000€. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të kreditorëve, Komuna pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitin e ardhshëm.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pyetësin e vet-vlerësimit;
- Planin vjetor të prokurimit publik;
- Raportimin mujor të obligimeve të papaguara; dhe
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe të hyrave me MF/Thesar.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2019 ishin prezantuar disa gabime, të cilat menaxhmenti i kishte përmirësuar në PFV-të e korrigjuara, me përjashtim të çështjeve të prezantuara te opinionit i auditimit. Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Kjo kërkon veprime specifike për të konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe shpалosjen e drejtë të tyre në PFV. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë adresuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronave përfshirë edhe rishikimin e PFV-ve të vitit 2019 nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, të hyrat, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna kishte shpenzuar 91% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim mjaft të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Në anën tjetër planifikimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale vazhdon të mbetet sfida kryesore për Komunën. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim për të parandaluar: angazhimin me marrëveshje të veçanta jashtë procedurave, anashkalimin e rregullave të prokurimit, ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt, rritjen e pagesave me vendime gjyqësore dhe vonesave për përfundimin e projekteve kapitale. Më tutje, Komuna duhet të ndërmarrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të pasurisë dhe obligimeve, çështje këto të ngritura edhe në raportin e vitit paraprak.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>23,266,602</b>	<b>25,311,504</b>	<b>23,109,387</b>	<b>20,942,026</b>	<b>19,437,159</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	19,777,274	20,063,988	19,746,629	16,971,867	16,685,007
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup>	-	1,194,641	1,073,613	1,080,250	544,035
Të hyrat vetjake	3,141,143	3,141,143	2,009,169	2,026,574	2,004,529
Donacionet e brendshme	-	102,725	55,583	-	30,078
Donacionet e jashtme	-	455,176	195,647	863,335	173,510
Financimi nga huamarrja	348,185	353,831	28,746	-	-

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,044,902€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, donacioneve, dhe ndryshimeve buxhetore përmes vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2018, Komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 23,109,387€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2017.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>23,266,602</b>	<b>25,311,504</b>	<b>23,109,387</b>	<b>20,942,026</b>	<b>19,437,159</b>
Pagat dhe Mëditjet	13,488,611	13,309,539	13,252,491	12,756,145	12,916,157
Mallrat dhe Shërbimet	2,240,270	2,451,892	2,234,275	1,729,401	1,733,534
Shërbimet komunale	561,899	578,736	549,083	529,428	567,520
Subvencionet dhe Transferet	439,982	504,155	459,573	450,163	499,615
Investimet Kapitale	6,535,840	8,467,182	6,613,965	5,476,889	3,720,333

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Paga e mëditje - Në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është zvogëluar për 179,073€. Fillimisht buxheti fillestar ishte rritur për 34,214€ nga donacionet dhe në fund të vitit me shkurtime buxhetore është zvogëluar për 213,286€;
- Mallra e Shërbime - Në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është rritur për 211,622€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat e bartura në vlerë 114,675€, donacionet 93,559€, dhe 3,388€ me rregullimet buxhetore nga qeveria;
- Shërbime Komunal - Në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është rritur për 16,837€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 15,817€ dhe donacioneve në vlerë 1,020€;
- Subvencionet dhe Transferet - Në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është rritur për 64,173€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 61,214€ dhe donacioneve në vlerë 2,960€; dhe
- Investimet Kapitale - Në krahasim me buxhetin fillestar, buxheti final është rritur për 1,931,342€. Rritja është rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 1,002,935€, donacionet 426,150€, me aprovim të qeverisë 500,000€, dhe në fund me rregullimet buxhetore është zvogëluar për 2,258€.

---

**Çështja B2<sup>3</sup> - Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale**

**Gjetja** Komuna duhet të realizojë buxhetin konform ndarjeve buxhetore të përcaktuar me Ligjin e buxhetit dhe planin e rrjedhës së parasë.

Komuna nuk ka arrit të realizojë buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve, pasi vetëm 78% e buxhetit për investime kapitale ishte realizuar, duke rezultuar me një suficit prej rreth 1.9mil€. Në 14 projekte me buxhet prej 519,296€ nuk ishte realizuar asnjë pagesë gjatë vitit 2018, kjo ngase alokimet ishin bërë me vonesë, përderisa për projektin "Masat e energjisë eficiente në ndërtesat publike në nivel komunal", në vlerë 287,500€, mjetet nuk ishin alokuar në llogarinë buxhetore të komunës..

Ekzekutimi i ulët i projekteve kapitale mbetet sfida kryesore e cila nuk po adresohet përkundër që ishte trajtuar edhe në raportet e mëparshme të auditimit. Shkaktarë të ekzekutimit të ulët janë të hyrat e fund vitit dhe pamundësia për shfrytëzimin e tyre, vonesat në realizim të kontratave, planifikimet e dobëta, vonesat në procedurat e prokurimit dhe menaxhimi jo i mirë i kontratave.

**Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

---

<sup>3</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

**Çështja B3 - Regjistrim i të hyrave dhe shpenzimeve në kode ekonomike jo përkatëse**

**Gjetja** Me rregullat e Thesarit dhe planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar kategoritë dhe kodet ekonomike sipas llojit. Ne vërejtëm se:

- Taksat vjetore për ushtrim të veprimtarisë (aktivitetit afarist) në vlerë prej 65,171€ janë regjistruar gabimisht në kodin ekonomik Licencat për regjistrim të biznesit. Gjithashtu, edhe të hyrat nga qiraja në vlerë prej 3,159€ janë regjistruar gabimisht në kodin ekonomik - Participimet, përderisa e hyra ka të bëjë me shfrytëzimin e hapësirës publike; dhe
- Në 9 raste (5 nga IK dhe 4 nga MSH) në vlerë prej 190,101€ shpenzimet nuk ishin regjistruar në kodet përkatëse ekonomike.

Shkak i klasifikimit të gabuar nëpër kode ekonomike është mungesa e kontrolleve të brendshme dhe pakujdesia e zyrtarëve përgjegjës.

**Rreziku** Regjistrimi i të hyrave dhe shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate ndikon negativisht në shpalosjen e drejtë të tyre në PVF, dhe mos informimin e drejtë për vendim marrësit dhe shfrytëzuesit e informatave financiare.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë në mënyrë që shpenzimet dhe të hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.

**3.1.1 Të hyrat**

Të hyrat e realizuara në vitin 2018 ishin 3,121,665€<sup>4</sup>. Ato janë mbledhur kryesisht nga tatimi në pronë, participimet e qytetarëve, lejet e ndërtimit, taksat për matjen e tokës, taksat nga regjistrimi i automjeteve, dhe taksa tjera komunale.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	3,141,143	3,141,143	3,121,665	2,684,461	3,204,552

<sup>4</sup> Në këtë vlerë nuk janë përfshirë të hyrat e përfituara nga Komuna nga dënimet e policisë në vlerë 516,774€, nga dënimet e gjykatave në vlerë 83,140€ dhe nga Agjencioni i Pyjeve 36€.

---

Përqindja e realizimit në raport me planin vjetor të hyrave është 99%. Krahasuar me vitin e kaluar kemi rritje në realizim të planit për 19%.

---

### **Çështja A1 - Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare**

**Gjetja** Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat përcakton që paratë e grumbulluara nga Organizatat Buxhetore (OB) nga arkëtimet për shërbime në lartësi deri 10€, duhet në fund të ditës të depozitohen në llogarinë bankare.

Ne kemi vërejtur se arkëtimet në vlerë prej 3,237€, të mbledhura nga taksat për certifikatat e lindjes të grumbulluara brenda 7 ditëve, ishin deponuar me vonesë në bankë. Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta të mbikëqyrjes nga niveli menaxherial.

**Rreziku** Parregullsitë e tilla mund të rrisin rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimin e parasë së gatshme.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë monitorim përmes menaxherit të financave për të siguruar se në fund të ditës të gjitha paratë e gatshme të arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve komunale deponohen në llogarinë bankare.

### **3.1.2 Pagat dhe mëditjet**

Pagat dhe kompensimet shtesë paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Sipas listës së pagave, në fund të vitit 2018, Komuna kishte 2273 të punësuar, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 13,252,491€ apo gati 100% e buxhetit. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale është 57%.

Auditimi ynë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, pensionimet, pushimet pa pagesë dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtorit përkatëse, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS).

---

## Çështja C1 - Parregullsi në menaxhimin e procedurave të rekrutimit

### Gjetja

Procesi i rekrutimit për shërbyesit publik duhet të udhëhiqet në pajtim me kërkesat e ligjit të punës dhe UA MPMS 07-2017. Ndërsa, me Rregulloren nr. 02/2010 për rekrutim në shërbimin civil, janë përcaktuar kriteret dhe kërkesat që duhet të zbatohen me rastin e rekrutimit të personelit.

Nga shqyrtimi i 4 proceseve të rekrutimit për mësimdhënës të zhvilluara nga DKA, kemi identifikuar se:

- Në dy raste, afati i konkursit ishte caktuar vetëm 8 ditë, e jo 15 ditë sa është e përcaktuar me UA nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik;
- Kandidatja e përzgjedhur për mësimdhënëse ishte caktuar në pozitën *zëvendësim*, ndonëse kishte aplikuar për pozitën e lirë dhe kishte pikë maksimale nga kandidatët tjerë. Një tjetër kandidate më me pak pikë të vlerësimit ishte caktuar në pozitën e lirë;
- Në dy raste, në lëndë mungonte vendimi për caktimin e komisionit përzgjedhës dhe raporti i kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë; dhe
- Në një rast në lëndë mungonte testi me shkrim i kandidates së punësuar dhe vlerësimet individuale të anëtarëve dhe se informatat për konkursin nuk ishin publikuar në web faqe të Komunës. Kontrata ishte nënshkruar menjëherë pas publikimit pa kaluar afati i ankesave.

Nga shqyrtimi i tre procedurave të rekrutimit, të zhvilluara nga DSHMS, kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në dosjen e rekrutimit për pozitën Infermier në QKMF, janë identifikuar këto mangësi: konkursi ishte publikuar në një gazetë ditore, por jo edhe në web faqen e komunës, kjo si rezultat i disa problemeve teknike të web faqes; aplikacioni për punësim nuk ishte plotësuar si duhet dhe nuk ishte nënshkruar nga e punësuar.

Nga shqyrtimi i 3 procedurave të rekrutimit, të zhvilluara nga zyra e personelit, identifikuam mangësitë në vijim:

- Në pozitën për Zyrtar Zotues të buxhetit, disa nga përgjigjet e dhëna nga kandidati i punësuar në pyetjet e testit me shkrim ishin të njëjta me përgjigjet e mundshme të shabllonit/testit me shkrim; dhe
- Në komisionin përzgjedhës nuk ishte përfshirë edhe një anëtar nga zyra e personelit, kjo me arsyetimin se anëtari i personelit nuk kishte kualifikim të lartë.

Mangësitë e lartë përmendura janë rezultat i mbikëqyrjes së pamjaftueshme menaxheriale në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjen e personelit.

**Rreziku**

Anashkalimi i rregullave dhe procedurave në proceset e rekrutimit rritë rrezikun që procesi të devijohet duke reflektuar edhe në mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve jo meritor.

**Rekomandimi C1**

Kryetari duhet të sigurojë se proceset e rekrutimit janë duke u zhvilluar në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit. Komisionet përzgjedhëse të jenë profesionale dhe të dokumentojnë si duhet të gjitha fazat e procesit të rekrutimit.



---

**Çështja B4 - Mangësi në angazhimin e punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta****Gjetja**

Ligji për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212 i rregullojnë çështjet e angazhimeve të punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Angazhimet e tilla lejohen të bëhen vetëm për punë specifike dhe në kushte të veçanta e të paparashikuara. Gjatë vitit Komuna kishte angazhuar 94 punonjës përmes MSHV-ve pa zhvilluar ndonjë procedurë formale të rekrutimit, e ku një numër i tyre ishin angazhuar për mirëmbajtjen dhe sigurimin e objekteve.

Ne vërejtëm se mungonin kërkesat apo arsyetimet për nevojën e angazhimit të punonjësve, dhe në kontrata nuk ishte përcaktuar se me cilën bazë ligjore<sup>5</sup> ishin kontraktuar shërbimet. Komuna nuk ka ofruar evidencë të saktë rreth numrit të personelit të punësuar me MSHV, pasi sipas listave të komunës numri i të angazhuarve ishte 72, derisa nga llogaria e Thesarit vërehet se janë paguar 94 punonjës. Gjatë vitit 2018, nga të angazhuarit me MSHV, përmes procedurave të rekrutimit 6 ishin punësuar me kontratë të rregullt.

Po ashtu, Komuna kishte ndalur në burim dhe kishte paguar kontributet pensionale për këta punonjës, por meqenëse këta kontraktues të shërbimeve nuk janë punonjës të rregullt dhe nuk janë të përfshirë në listën e pagave, Komuna me rastin e pagesës së kompensimit mujor, nuk u kishte ndalur kontributin e paguar në emër të punëdhënësit prej 5%. Në këtë rast, kostoja mujore e pagesës për personin e angazhuar i kishte kushtuar komunës 5% më tepër se sa shuma e kontraktuar.

**Rreziku**

Angazhimi i stafit për shërbime të veçanta pa ndonjë kërkesë apo arsye dhe pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit vë në dyshim nevojën për këto angazhime dhe zvogëlon konkurrencën. Pagesa prej 5% nga kompensimi i përcaktuar me MSHV i ka shkaktuar Komunës kosto shtesë buxhetore.

**Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit për punët që konsiderohen të realizohen përmes MSHV-ve. Nevojat për pozitat të rregullta të punës të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor, e jo të aplikohen MSHV. Kjo formë e angazhimit të kontraktuesve të aplikohet vetëm në rastet urgjente, dhe kur kërkesat të jenë të arsyetuara nga njësitë kërkuese. Pagesat për shërbimet e tilla nuk duhet të tejkalojnë vlerën e kontraktuar.

---

<sup>5</sup> Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil lejon këto kontrata deri në 6 muaj dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212 lejon 4 muaj.

---

**Çështja A2 – Mangësi në kalkulimin e përvojës së punës dhe të pagave****Gjetja**

Me vendim të qeverisë nr.06/2015, dhe Qarkores së Ministrisë së Administratës Publike janë përcaktuar dëshmitë që punonjësit duhet të ofrojnë për të përfituar shtesë në pagë për përvojën e punës. Punonjësit që kanë punuar në sektorin privat kërkohet të ofrojnë dëshmi për përvojën e punës duke bashkëngjitur edhe dëshmitë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale.

Për dy punonjës të administratës komunale numri i viteve të përvojës së punës nuk ishte mbështetur me dëshmi të mjaftueshme. Punonjësit kishin ofruar llogarinë e kursimeve pensionale, por se të njëjtat nuk ishin mbështetur në të gjitha rastet edhe me dëshmi/vërtetim pune nga punëdhënësit. Gjithashtu, një punonjëse të QKMF-së, i është llogaritur një vit më shumë përvojë pune se sa dëshmitë e ofruara.

Në dy raste, DKA nuk ka kalkuluar saktë ndalesat në pagë, për punonjësit që kishin filluar pushimin pa pagesë. Punonjësit kishin filluar pushimin pa pagesë nga gjysma e muajit, ndërsa ishin kalkuluar paga të plota mujore.

Gjithashtu, një mësimdhënëse kishte pranuar nga dy paga për dy muaj. Në njërin shkollë e punësuar kishte kontratë të rregullt pune, me 40 orë pune në javë, ndërsa në shkollën tjetër kishte kontratë pune për 20 orë në javë. Sipas kontratave, e punësuar kishte arritur numrin e 60 orëve të punës brenda javës, gjë që bie në kundërshtim me Ligjin e Punës<sup>6</sup>. Kjo kishte ndodhur me qëllim të mos humbjes së orëve mësimore për shkak të mungesës së përkohshme të personelit mësimor.

Mangësitë e përmendura janë rezultat i kontrolleve jo adekuate në kalkulimin e kompensimeve dhe ndalesave në pagë.

**Rreziku**

Mungesa e dëshmimeve rreth përvojës së punës nuk garanton se kandidatët kanë përvojën e deklaruar të punës. Kalkulimet jo të drejta të pagave dëmtojnë buxhetin e komunës.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë se zyra e personelit i përmbahet kërkesave të vendimit të qeverisë për dëshmitë që të punësuarit duhet të ofrojnë për të përfituar shtesën në pagë për përvojën e punës. Ndalesat në paga dhe kompensimet të kalkuloohen saktë dhe të realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.

---

<sup>6</sup> Sipas nenit 20 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 orari i plotë është 40 orë në javë, kurse sipas nenit 23 puna më e gjatë se orari i punës është deri në 8 orë në javë.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 3,030,628€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,783,358€. Kryesisht ato kanë të bëjnë me aktivitetet operative që ndërlidhen me shpenzimet për shërbime tjera kontraktuese, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, furnizim për zyre dhe pajisje, derivate, regjistrim dhe sigurim të automjeteve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe me shpenzimet e shërbimeve komunale etj.

#### Çështja B5 - Mangësi në certifikimin e pagesave

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare 01/2013-MF -për shpenzimin e parasë publike, lëndët duhet të certifikohen vetëm pasi ato të jenë të kompletuara dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Nga testimet kemi gjetur se:

- Furnizimet me derivate për ngrohje të muajit dhjetor, ishin kalkuluar me çmimet e berzhës së muajit nëntor. Lëndës i mungonin edhe fletëporositë për furnizim me derivate. Pagesa e certifikuar ishte në vlerë 6,507€. Ndërsa, për shpenzimet e reprezentacionit Komuna nuk kishte kontratë për shërbime të bufesë përbrenda objektit të komunës; dhe
- Në një rast certifikimi i shpenzimeve përkatësisht mbyllja e avancit për udhëtime zyrtare jashtë vendit ishte bërë me 5 muaj vonesë. Udhëtimi zyrtar ishte realizuar në muajin korrik, ndërsa kërkesa për udhëtim zyrtar dhe avansi ishte mbyllur në fund të muajit dhjetor.

**Rreziku** Lëndët e pa kompletuara dhe paqartësitë rreth sasisë së furnizimeve dhe nivelit të çmimeve të aplikuara mund të rezultojnë me pagesa të parregullta të cilat në raste të caktuara mund ta dëmtojnë buxhetin e komunës.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në certifikimin e pagesave. Vetëm lëndët që jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm të procesohen për pagesë.

### 3.1.4 Subvencionet dhe Transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2018 ishte 504,155€. Prej tyre ishin shpenzuar 459,573€. Subvencionet janë dedikuar kryesisht për entitete jo publike 69%, ndërsa pjesa tjetër për përfitues individual. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare në fushën e ekonomisë, sportit, bujqësisë dhe shëndetësisë.

---

### Çështja A3 – Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

- Gjetja** Në menaxhimin me subvencione kemi identifikuar mangësitë si në vijim:
- Komuna ka mbështetur financiarisht bizneset me synimin e zgjerimit dhe forcimit të kapaciteteve të tyre dhe nxitjen e punësimit. Te thirrja për aplikim për grant një nga kriteret ishte kërkesa që biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Biznesi që ka përfituar mbështetje financiare nga Komuna nuk ka ofruar dëshmi se ka punësuar një punëtor; dhe
  - Me kontratën për ndërtimin e 35 serave profesionale të tipit tunel, në vlerë 44,765€, kontraktuesi sipas nenit 1.7 të kontratës obligohet që pas pranimit të punimeve të bëjë depozitimin e sigurisë së punimeve prej 10% të vlerës së kontraktuar për 12 muaj. Komuna nuk na ka ofruar ndonjë dëshmi që OE ka bërë depozitimin e sigurisë së punimeve.
- Rreziku** Mos përmbushja u kushteve sipas marrëveshjes (punësimi i një punëtori) dhe mungesa e depozitimit të sigurisë së punimeve rritë rrezikun që subvencionet e dhëna të mos e arrijnë qëllimin e synuar.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të siguroj se përfituesit e granteve plotësojnë në tërësi kushtet e marrëveshjeve për financim. Po ashtu, duhet të sigurohen format e përshtatshme të ndalesave në emër të sigurisë apo garancionit të punimeve. Nëse OE nuk i përmbahet kushteve kontraktuale, Komuna të vlerësoj si mundësi ndalesën e sigurisë së ekzekutimit të kontratës ose mos pagesën e situacionit të fundit të punimeve.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti për investime kapitale ishte 8,467,182€, prej tyre ishin shpenzuar 6,613,965€ apo 78%. Investimet kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturën rrugore, ndërtimin dhe renovimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, mirëmbajtje investive, rrjet të kanalizimit dhe ujësjellësit, furnizim me pajisje, etj.

---

## Çështja C2 - Dobësi në prokurim dhe menaxhim të projekteve kapitale

### Gjetja

Blerjet përmes prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, dhe udhëzuesit e prokurimit duke respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Po ashtu, kontratat duhet të përfundohen sipas afateve në përputhje me planin dinamik. Ne kemi gjetur se:

- Pesë kontrata për investime kapitale të nënshkruara, një në vitin 2009, dy në vitin 2012, dhe dy në vitin 2013, nuk ishin përfunduar ende. Nënshkrimi i këtyre kontratave ishte bërë pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore. Sipas raportit të përgatitur nga Menaxheri i Kontratës, për këto projekte në vitin 2018 ishin bërë pagesa në vlerë 724,981€ nga 2,217,384€ sa ishte vlera e përgjithshme e këtyre kontratave;
- Te prokurimi për *“Ndërtimin e Qendrës së Kulturës në Rugovë të Hasit”*, në vlerë 999,210€, njëri nga anëtarët e konzorciumi të OE fitues, kishte ofruar dëshmi kontratat e qirasë me një OE tjetër, për shfrytëzimin e pajisjeve/makinerisë. Në kontratë ishte përcaktuar se pajisjet do të shfrytëzohen për vitet 2017 dhe 2018, ndonëse projekti ishte 3 vjeçar, për vitet 2018-2019-2020;
- Në njoftimin për kontratë te projekti *“Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni - Lot 1”*, në vlerë 776,827€, është kërkuar si kriter, që për stafin udhëheqës profesional të dëshmohej se kanë së paku 3 vite përvojë pune. OE fitues kishte ofruar referencë rreth përvojës së punës për njërin nga gjeodet, mirëpo në listën e punonjësve të deklaruar në ATK i njëjti nuk figuronte si i punësuar. OE kishte nënshkruar kontratë pune me të njëjtin gjeodet vetëm disa ditë para se të ofertonte për këtë tender. Dëshmitë e përvojës së punës ishin të mangëta edhe për dy inxhinier tjerë udhëheqës të punës;
- Te kontrata për *Ndërtimin e qarkores së qytetit lot 1*, në vlerë 2,167,952€ procedura e prokurimit ishte përcjellë me vonesa. Kjo ngase anëtarët e komisionit kishin vlerësime të ndryshme dhe mos pajtime se cili OE është më i suksesshëm. Pas ankesave të OE dhe shqyrtimit nga OSHP, oferta janë rivlerësuar nga një komision tjetër, të cilët edhe kanë vlerësuar si OE më të suksesshëm një tjetër OE, ndryshe nga dy OE të përzgjedhur paraprakisht nga anëtarët e komisioni të parë të vlerësimit të ofertave.

Shkak i mos përmbushjes së kontratave nga viti 2009 ishte fakti që këto kontrata ishin ndërprerë me ndryshimin e qeverisjes komunale për një mandat dhe tani në qeverisjen e re ato janë duke u realizuar. Përderisa mangësitë e tjera kanë ndodhur si rezultat i kontroleve jo adekuate në udhëheqjen prokurimit, menaxhimin e projekteve dhe nga dobësitë e komisioneve e vlerësimit.

**Rreziku**

Tej zgjatja e kontratave rrezikon të shkaktoj kosto shtesë në rast të prishjeve të punimeve paraprake apo kontesteve të mundshme gjyqësore, vlerë të dobët për paranë e shfrytëzuar, vonesa në krijimin e kushteve infrastrukturore për qytetarët dhe kontrata të cilat mund të mos zbatohen sipas standardeve. Po ashtu, kontraktuesit e përzgjedhur mund të mos kenë kapacitetet e duhura teknike dhe profesionale për realizimin e projekteve sipas kushteve kontraktuale

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të trajtoj me prioritet dhe të analizojë mundësitë buxhetore në implementimin e këtyre kontratave në afatin më optimal të mundshëm. Po ashtu, komisionet e vlerësimit të tenderëve duhet të vlerësojnë drejtë kriteret dhe analizojnë mirë dëshmitë e ofruara nga ofertuesit dhe OE që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë.

**Çështja A4 - Parregullsi në sigurim të ekzekutimit, planifikim dhe realizim të kontratave****Gjetja**

Sipas LPP-së dhe Udhëzuesit të Prokurimit publik, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës.

Te kontrata për *Asfaltimin e rrugëve në fshatin Skivjan*, e vitit 2013, në vlerë 851,771€, Komuna ka kërkuar që afati i SE të jetë vetëm për një vit, kurse për pjesën tjetër SE do të bëhet për çdo situacion të punimeve, përderisa sipas rregullave shuma e sigurimit të ekzekutimit duhet të jetë e plotë. Afati i implementimit të projektit ishte 120 ditë, ndërsa projekti ende nuk ka përfunduar. Në mungesë të mjeteve buxhetore Komuna ka paguar vetëm 58,070€ nga vlera e situacionit të VII-të të punimeve në vlerë 80,922€;

Kontrata për *Asfaltimi i rrugës në fshatin Gërqinë prej 1.85 kilometra*, në vlerë 161,148€, ishte planifikuar që të realizohet brenda 3 viteve, përderisa plani dinamik për kryerjen e punëve ishte 70 ditë kalendarike. Marrë parasysh, madhësinë e projektit/gjatësinë e rrugës, vlerën e kontratës dhe afatin e implementimi shihet një planifikim jo i drejtë;

Te kontrata për *Asfaltimi i rrugës në fshatin Gërgoc prej 2.4 kilometra*, e nënshkruar në vitin 2016, në vlerë 120,523€, ishte planifikuar që të realizohet brenda viteve 2016-2017-2018 përderisa plani dinamik për kryerjen e punimeve ishte 45 ditë pune. Marrë parasysh, madhësinë e projektit/gjatësinë e rrugës, vlerën e kontratës dhe afatin e implementimit shihet një planifikim jo i drejtë. Projekti ishte në vonesë, pasi situacioni i dytë i punimeve është nënshkruar në fund të vitit 2018, me realizim të 69% të punimeve. Me ligjin e buxhetit të vitit 2018, ishin planifikuar vetëm 50,522€ ndonëse Komuna kishte obligime kontraktuale më të mëdha, për pjesën e papërfunduar të projektit. Komuna ka paguar vetëm sa kishte buxhet duke mbetur pa paguar pjesa prej 4,884€ nga situacioni i punimeve në vlerë 55,356€;

Kontrata për *Asfaltimin e rrugës Shishman i Bokës - Mazrek*, në vlerë 193,003€, ishte nënshkruar në vitin 2009, dhe plani dinamik i kryerjes së punimeve ishte 48 ditë pune. Projekti ende nuk ishte përfunduar. Deri në situacionin e IV ishin realizuar vetëm 68% e punimeve;

Pagesa në vlerë 66,374€, për kontratën *Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni*, ishte realizuar nga buxheti i një projekti tjetër – Parku i qytetit; dhe

Planifikime të dobëta buxhetore kishte edhe te projekti *Asfaltimi i rrugës në Zhabel*, në vlerë 337,424€. Kontrata ishte paraparë të realizohet brenda viteve 2017-2018. Në vitin 2017, për këtë projekt janë shpenzuar 99,901€, ndërsa në vitin 2018 janë shpenzuar 100,000€ aq sa janë planifikuar. Në vitin 2019 janë planifikuar me buxhet edhe 167,422€. Nga kjo shihet një planifikim jo i drejtë buxhetor në raport me afatin kohor të përcaktuar për realizim të kësaj kontrate.

Komuna ka kontraktuar një kompani për mbikëqyrjen e projekteve kapitale. Përveç nënshkrimit të situacioneve teknike të punimeve, raportet e përgatitura nga kompania mbikëqyrëse nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për menaxhmentin rreth ecurisë së realizimit të punimeve, vonesat e ndodhura, ndryshimet apo çështje tjera ndërlidhur me implementimin e kontratës. Komuna kishte caktuar edhe një punonjës të komunës në menaxhimin e kontratave/projekteve kapitale. Përveç nënshkrimit të situacioneve të punimeve, dhe hartimit të një raporti përmbledhës për të gjitha projektet e menaxhuara, menaxheri i kontratave nuk hartonte raporte individuale me shkrim për situacionet e punimeve të pranuar. Planet e menaxhimit të kontratës, përveç nënshkrimit fillestar, nuk azhurnoheshin me informata të reja lidhur me realizimin e projekteve.

**Rreziku**

Planifikimet e dobëta buxhetore, hyrja në obligime pa mjete të mjaftueshme buxhetore dhe zgjatja e implementimit të projekteve ndikon negativisht në cilësinë e punimeve të realizuara pjesë-pjesë, apo nga njëra fazë në tjetrën, duke e rrezikuar mos implementimin e projekteve. Në mungesë të informatave të mjaftueshme, menaxhmenti mund të mos ketë njohurinë në rastet kur kontratat nuk po realizohen në pajtim me kushtet kontraktuale.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe në afatin kohor të arsyeshëm të implementimit të kontratës. Hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Menaxherët e kontratave të ofrojnë informata të mjaftueshme dhe relevante lidhur me procesin e implementimit të projekteve kapitale. Planet e menaxhimit të kontratave të përmbajnë informata të nevojshme lidhur me afatet, pagesat, dhe progresin e kontratave.



---

**Çështja A5 - Aprovimi për pagesë i punimeve dhe autorizimi për punimet/furnizimet e pa realizuara****Gjetja**

Projektet duhet të realizohen sipas paramasës dhe parallogarisë së përcaktuar me dosjen e tenderit dhe kontratë. Furnizimet duhet të jenë në përputhje me sasinë dhe cilësinë e përcaktuar me kontratë. Sipas LPP-së, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Vetëm punët e realizuara duhet të përfshihen në situacionin e punimeve të përgatitur për pagesë.

Nga inspektimi fizik i projektit *Ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë*, në vlerë 802,174€, kemi gjetur se disa pozicione/punë në vlerë 51,148€ nuk ishin realizuar sipas paramasës/kontratës, ndonëse të njëjtat ishin pranuar nga menaxheri i kontratës dhe ishin përfshirë në situacionin e punimeve si të përfunduara dhe të cilat ishin paguar. Projekti është financuar nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa punimet mbikëqyren nga Komuna e Gjakovës. Bëhet fjalë për këto pozicione apo furnizime të përfunduara:

Pozicioni 13 – Punët e Zdrukthëtarisë

- Pozicioni 13.6a - Derë një krahëshe me mbi dritë, dimension 100/270 cm x 33 copë në vlerë 12,461€ nuk ishin vendosur, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara;
- Pozicioni 13.7b - Derë një krahëshe me dimension 75/200 cm x 3 copë në vlerë 4,532€ nuk ishin vendosur, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara;
- Pozicioni 13.8b - Derë dykrahëshe me dimension 200/200 cm x 4 copë në vlerë 8,874€ nuk ishin vendosur, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara;
- Pozicioni 13.3 - Furnizimi dhe montimi i 6 dyerve automatike rrëshqitëse në hyrjet kryesore të pranimit – vetëm 4 ishin të përfunduara, ndërsa 2 dyer ishin ende të papërfunduara vlera e një derë ishte 2,950€x2=5,900€, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara; dhe
- Në tërë objektin ishin vendosur 16 dyer të dimensioneve të ndryshme, përderisa sipas situacionit të punimeve numri i dyerve të pranuar si të përfunduara ishte 22 dyer.

---

### Pozicioni 1 - Ngrohja/Klimatizimi

1. Pozicioni 1.1 - Furnizimi dhe montimi i agregatit ftohës-ngrohës, (termo pompës) me kapacitet  $Q_{ft}=130$  KW dhe  $Q_{NG}=147$  KW rezervuarin dhe pompën (pompe e dyfishtë punese dhe rezervë), në vlerë 7,670€, nuk ishte vendosur, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara; dhe
2. Pozicioni 1.2 - Furnizimi dhe montimi i këmbyesit të nxehtësisë me kapacitet  $Q=500$  KW  $11,2=120/80 - 13/14=80/60$  max=16bar, në vlerë 1,357€ nuk ishte vendosur, përderisa janë pranuar dhe paguar si furnizime të përfunduara.

### Pozicioni 2.0 - Ventilimi

1. Pozicioni 2.1 - Pajisja për përgatitjen e ajrit (rikuperator) për montim të brendshëm, në vlerë 1,947€, nuk ishte vendosur, përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar.

### Pozicioni 4 Punët e instalimeve elektrike

1. Pozicioni 1.12 - Ndërprerës automatik, 3P-magneto termik, 220V, AC Tip DPX-200A, 35kA, copë 2, në vlerë 1,534€, nuk ishin vendosur përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar;
2. Pozicioni 1.13 - Ndërprerës automatik, 3P-magneto termik, 220V, AC Tip DPX-100A, 35kA, copë 1, në vlerë 767€, nuk ishte vendosur, përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar;
3. Pozicioni 1.14 - Ndërprerës automatik, 3P-magneto termik, 220V, AC Tip DPX-50A, 36kA, copë 4, në vlerë 2,360€ nuk ishin vendosur, përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar; dhe
4. Pozicioni 1.15 - Ndërprerës automatik, 3P-magneto termik, 220V, AC Tip DPX-32A, 36kA, copë 6, në vlerë 2,478€ nuk ishin vendosur, përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar; dhe

### Pozicioni 2.3 Sistemi i lajmëruesve të zjarrit

1. Pozicioni 2.01 - Detektor multi kriteria i tymit dhe i temperaturës me mikroprocesor, copë 43, në vlerë totale 1,268,50€, nuk ishin vendosur, përderisa ishte pranuar dhe paguar si furnizim i përfunduar.

Këto parregullsi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme dhe menaxhimit të dobët të projekteve nga menaxheri i kontratave.

**Rreziku** Dobësitë aktuale në monitorimin dhe menaxhimin e kontratave kanë rezultuar në mos përfundimin e punimeve sipas kushteve kontraktuale, dhe dëmtimin e buxhetit për pagesën e furnizimeve/punimeve të pa realizuara.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të përforcojë mekanizmat e kontrollit në menaxhimin dhe monitorimin e kontratave. Menaxherët e kontratave nuk duhet të pranojnë punët/ furnizimet e pa përfunduara.

### 3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

---

**Çështja B6<sup>7</sup> - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përbarimit**

**Gjetja** Neni 39 i LMFPF përcakton se organizata buxhetore është përgjegjëse për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Si rezultat i mos pagesës së obligimeve financiare me kohe, OE përmes Thesarit dhe procedurave përbarimore/gjykatave kishin realizuar të drejtat e tyre ligjore. Si rezultat, Ministria e Financave/Thesari nga buxheti i Komunës, kishte certifikuar nga kategoria e investimeve kapitale dhe ajo e mallrave dhe shërbimeve pagesa në vlerë 1,151,576€. Shpenzimet shtesë në emër të interesit dhe shpenzimeve gjyqësore ishin 68,455€. Arsyet e mos pagesës ishin mungesa e buxhetit si dhe disa konteste gjyqësore.

**Rreziku** Kosto shtesë buxhetore si rezultat i ngarkesave shtesë në emër të kamatave dhe shërbimeve të përbarimit nga paditë e kontraktuesve. Certifikimi i pagesave nga Thesari prej buxhetit komunale mund të ndikojë si në mos implementimin e projekteve prej nga janë marrë mjetet buxhetore si dhe në keq klasifikimin e shpenzimeve.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë që të mos hyjë në obligime kontraktuale dhe financiare pa sigurim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe të forcojë disiplinën financiare në pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.

---

<sup>7</sup> Në raportin e auditimit 2017 kjo çështje është trajtuar te çështja 10 kurse këtë vit e kemi trajtuar si të veçantë.

---

**Çështja B7<sup>8</sup> - Mangësi në planifikim, hyrje në obligime pa zotim të mjeteve dhe urdhër blerje me vonesë****Gjetja**

Me LMFPF dhe Rregullën Financiare 01/2013-MF, për shpenzimin e parasë publike, para hyrjes në obligime kontraktuale dhe krijimit të shpenzimit, AK duhet të zotojë në SIMFK mjetet e nevojshme buxhetore. Gjithashtu, urdhër blerja krijohet dhe përgatitet nga ana e OB-së, pas zgjedhjes së ofertuesit me të cilin është nënshkruar kontrata. Marrëveshja me shkrim në mes të Organizatës Buxhetore dhe furnitorit rezulton me shtypjen e urdhër blerjes. Kjo marrëveshje krijon obligim kontraktual.

Nga mostrat e testuara kemi identifikuar se në një raste Komuna kishte nënshkruar kontratë/marrëveshje bashkëfinancimi pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare, ndërsa në 3 raste tjera zotimet e mjeteve ishin të pamjaftueshme kundrejt shumës së obligimeve të krijuara. Për tre<sup>9</sup> kontrata publike kornizë, fillimisht ishin zotuar vetëm 28,050€, gjë që mund të konsiderohen vlera jo të mjaftueshme në krahasim me shpenzimet e mundshme për muajt vijues, ndërsa për kontratën për furnizim me autoambulancë në vlerë 59,000€, ishin zotuar fillimisht vetëm 15,000€.

Në 8 raste, zotimi i mjeteve dhe përgatitja e urdhër blerjeve ishte bërë pas pranimit të faturës, përkatësisht pas krijimit të obligimit, ndërsa në 6 raste tjera urdhër blerja ishte përgatitur me vonesë ndonëse mjetet ishin të zotuar në SIMFK. Kjo ka ndodhur si rezultat i planifikimeve të dobëta buxhetore dhe kontrole jo adekuate në menaxhim të projekteve.

Kontrata për Riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve në vlerë 55,000€ nuk ishte planifikuar në planin e prokurimit dhe as nuk ishte informuar AQP. Kontrata i është dhënë OE që kishte borxhe tatimore të papaguara;

**Rreziku**

Hyrja në obligime kontraktuale pa zotim të mjeteve buxhetore bart në vete rrezikun e mos përfundimit të kontratave sipas planifikimit. Përgatitja e urdhër blerjeve me vonesë krijon paqartësi rreth urdhëresave për furnizim apo ofrim të shërbimeve apo fillim të punimeve.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë se obligimet kontraktuale dhe financiare të mos krijohen pa u zotuar paraprakisht mjetet e duhura financiare në SIMFK. Urdhër blerjet e përgatitura dhe të nënshkruara duhet ti paraprijnë procesit të furnizimit apo realizimit të punimeve.

---

<sup>8</sup> Në raportin e auditimit 2017 kjo çështje është trajtuar te çështja 11

<sup>9</sup> Kontratat: 1. Furnizim me pajisje të IT-së, 2. Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme, dhe 3. Furnizim me fidanë të drunjëve dekorativ, luleve dhe pemëve frutore. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte vlerësuar 823,574€

### 3.1.7 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Sipas raportit të pasurisë të SIMFK-së, vlera neto e pasurisë kapitale është 56,008,622€, ndërsa vlera neto e pasurisë jo kapitale e shpalosur në PVF-të e vitit 2018 ishte 1,214,000€.

Komuna ka ndërmarrë veprime konkrete me qëllim adresimin e rekomandimit lidhur me menaxhimin e pasurisë, por nuk ka arrite të zbatojë atë në tërësi. Kryetari i Komunës kishte formuar një Komision punues për verifikimin e pronave komunale. Komisioni ka evidentuar pronat komunale dhe kishin përgatitur raporte pune rreth procesit të verifikimit. Megjithatë, Komuna ende nuk ka bërë vlerësimin financiar dhe regjistrimin e pronave në regjistrin kontabël të pasurisë në SIMFK.

---

## Çështja B8 - Mangësi në menaxhimin e Pasurive

### Gjetja

Rregulla për menaxhimin e pasurive nr. 02/2013 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Ndërsa, udhëzimi administrativ nr. 2008/01 për menaxhimin e automjeteve zyrtare në komuna, përcakton kërkesat dhe procedurat që duhet të zbatohen nga zyrtarët kur përdoren automjetet zyrtare. Zyrtarët mund të shfrytëzojnë automjetet zyrtare vetëm pasi kërkesa të jetë aprovuar nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë.

- Komuna nuk ka rregulla dhe procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë, inventarizim dhe vlerësim të pasurisë, si dhe udhëzim apo procedurë për përdorimin e automjeteve komunale;
- Me gjithë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti, Komuna ende nuk ka arrit të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurisë kapitale dhe jopakitale, por edhe të stoqeve apo materialit shpenzues. Ne verifikuam se pajisjet në vlerë 4,320 nuk ishin regjistruar në programin e-pasuria. Po ashtu, nuk është llogaritur zhvlerësimi vjetor dhe zhvlerësimi i akumuluar për pasurinë jo kapitale;
- Komisioni për inventarizim të pasurisë komunale ishte caktuar në fillim të vitit 2019, dhe deri në kohën e përfundimit të auditimit, komisioni punues ishte ende në proces të punës. Sipas rregullores, OB duhet të kontrollojë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare, dhe se rezultatet e këtij procesi duhet të reflektojnë në pasqyrat vjetore financiare; dhe
- Komuna menaxhon automjetet përmes një aplikacioni/programi elektronik dhe se ka vënë në funksion sistemin e monitorimit elektronik të automjeteve (GPS). Testimet e tri dosjeve të automjeteve, kanë rezultuar me mungesën e kërkesave nga zyrtarët për përdorim të veturave zyrtare dhe aprovimet nga niveli mbikëqyrës. Mungonin edhe aprovimet në rastet kur janë përdorur veturat private për qëllime zyrtare, në disa raste qëllimi i shfrytëzimit të automjetit, si dhe shënime rreth shpenzimeve të riparimeve Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos funksionimit të disa moduleve në aplikacionin apo programin që përdor Komuna. Në vitin 2019, menaxhmenti ka evituar këtë mangësi dhe ka funksionalizuar modulën e kërkesave dhe aprovimeve për shfrytëzim të veturave si dhe riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

### Rreziku

Mungesa e rregullave të brendshme për menaxhim të pasurisë, si dhe mungesa e një regjistri të plotë e të saktë të pasurisë vështirëson menaxhimin e duhur të pasurisë, dhe se kjo krijon parakushte për humbjen apo keqpërdorimin e pasurisë. Mungesa e informatave të plota dhe të sakta pamundëson edhe përmbushjen e kërkesave ligjore për raportim të drejtë financiar të pasurisë.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ligjore për menaxhim dhe regjistrim të pasurisë. Përmes programit e-pasuria të aplikohet kalkulimi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale. Procesi i inventarizimit të pasurisë të përfundojë para përgatitjes së PVF, me qëllim që ndryshimet e identifikuara përmes inventarizimit të reflektojnë në shpalosjen e drejtë të pasurisë.

## 3.2 Të arkëtueshmet

Bilanci përfundimtar i llogarive të arkëtueshme (LL/A) në fund të vitit 2018 sipas pasqyrave vjetore të Komunës ishte 8,872,764€. LL/A kanë të bëjnë me tatimin në pronë në shumë prej 7,967,656€, ku nga kjo vlerë, sipas evidencës së Komunës, vetëm të arkëtueshmet e ndërmarrjeve shoqërore të manaxhuara nga AKP janë 3,085,740€ apo 40% e totalit të Ll/A. Vlera totale e llogarive përfshinë edhe taksa në biznes 627,118€ dhe të hyrat nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale në vlerë 277,990€.



## Çështja B9 - Menaxhim jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

### Gjetja

Me ligjin për tatimin në pronë, rregulloren për taksa dhe ngarkesa komunale, si dhe kontratat e nënshkruara të qiradhënies janë përcaktuar afatet kohore të pagesave. Nga testimet kemi vërejtur se:

- Trendi i të arkëtueshmeve është në rritje të vazhdueshme nga viti në vit gjersa krahasuar me vitin paraprak borxhet ndaj Komunës që kanë të bëjnë me tatimin në pronë janë rritur për 367,000€. Sfidë mbetet edhe arkëtimi i taksave në biznes si dhe arkëtimi i të hyrave nga shfrytëzimi i pronës komunale;
- Në një rast, kontraktuesit i kishte skaduar kontrata në vitin 2015, përderisa prona vazhdonte të shfrytëzohej edhe më tutje. Për më tepër, kontraktuesi as nuk kishte paguar për shfrytëzimin e parcelës, dhe saldoja e borxhit të papaguar ndaj Komunës ishte 5,376€; Në rastin tjetër, qiramarrësi i pronës komunale nuk kishte paguar për gati 10 vite, dhe borxhi i papaguar ndaj komunës ishte 48,225€; dhe
- Informatat në dispozicion rreth llogarive të arkëtueshme ishin të mangëta. Komuna nuk kishte informata/evidencë rreth ngarkesave dhe pagesave mujore për 4 kontrata me bizneset private për shfrytëzimin e pronave komunale të lidhura në vitet 2009-2017. Për më tepër, në njërin nga kontratat, kushtet kontraktuale nuk ishin aspak të favorshme për komunën.

Dobësitë e përmendura më lartë janë për shkak të kontrolleve jo adekuate dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme në përmbushjen e kontratave dhe menaxhimit të llogarive të arkëtueshme.

### Rreziku

Mos pagesa e borxheve dhe vonesat në arkëtimin e të hyrave reduktojnë fondet e mbledhura për buxhetin komunal, dhe me ndikim direkt në më pak projekte të financuara nga fondi i të hyrave vetanake. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.

**Rekomandimi B9** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, zyra e financave të mbajë një regjistër të konsoliduar dhe të plotë të ngarkesave dhe pagesave mujore përgjatë viteve për shfrytëzuesit e pronave komunale.

## 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të pa paguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 660,000€. Kjo vlerë përfshinë obligimet e shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale, subvencione, mallra e

---

shërbime si dhe shpenzimet komunale. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Komuna ka shpalosur edhe obligimet kontraktuale për situacionet e punimeve të përfunduara por të pa faturuara në vlerë 772,611€ dhe obligimet lidhur me vendimet për shpronësime në vlerë 1,105,368€.

Ne krahasim me vitin paraprak, Komuna ka arrit të zvogëlojë nivelin e borxheve të faturuara për 631,000€. Me gjithë këtë, menaxhmenti duhet ti kushtojë kujdes dhe vëmendje shtese në uljen e nivelit të obligimeve dhe pagesën e tyre brenda afateve kohore ligjore.

---

### Çështja C3 - Vonesë në pagesën e obligimeve

**Gjetja** Sipas LMFPF dhe Rregullës Financiare 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, OB duhet të paguajnë obligimet brenda 30 ditëve pas pranimi të faturës. Me gjithë progresin e arritur, niveli i obligimeve ndaj kontraktuesve ende është në nivel të konsiderueshëm. Siç është prezantuar në PVF borxhet datojnë nga viti 2012 e tutje.

Testimet tona tregojnë se në 4 raste, pagesa e obligimeve nuk është bërë brenda afatit kohor prej 30 ditëve, por me vonesë nga dy deri tre muaj. Po ashtu, në 3 fatura/raste, obligimet ishin paguar vetëm pjesërisht, duke mbetur papaguar në total pjesa prej 62,538€. Shkak i mos pagesës me kohë të obligimeve apo mos pagesës së plotë të borxheve ishte hyrja në obligime financiare pa u zotuar mjetet e nevojshme financiare në SIMFK.

**Rreziku** Vonesat në pagesën e obligimeve rrisin rrezikun për kosto shtesë buxhetore në rast të padive të mundshme nga kreditorët për mos pagesën me kohë të obligimeve.

**Rekomandimi C3** Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet krijohen vetëm pasi të jenë zotuar paraprakisht mjetet financiare në SIMFK. Pagesa e obligimeve të bëhet brenda 30 ditësh nga pranimi i faturës.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

---

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në fushën e raportimit dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut nuk pasqyron një situatë pozitive. Me gjithë progresin e arritur, ende nuk janë finalizuar veprimet në zhvillimin e një procesi formal në menaxhimin e riskut, dhe identifikimin e rreziqeve potenciale që mund të kenë ndikim negativ në arritjen e objektivave të organizatës. Komuna nuk ka trajtuar sa duhet dhe nuk ka ndërmarrë masa zbatimi për një pjesë të rekomandimeve të viteve paraprake. Komiteti i auditimit është krijuar, megjithatë rekomandimet e AB-së nuk janë adresuar sa duhet.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna e Gjakovës ka Strategjinë zhvillimore socio-ekonomike 2016-2018, planin lokal të veprimit 2018-2022, janë hartuar planet vjetore të punës nga drejtoritë komunale dhe raportet e punës për vitin 2018.

### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. NjAB ka përmbushë programin vjetor të auditimit dhe ka realizuar 5 auditimet e planifikuara. Është përgatitur edhe plani strategjik 2018-2020. Menaxhmenti ka adresuar rekomandimin e vitit të kaluar lidhur me Komitetin e Auditimit. Në fillim të vitit 2018, është formuar Komiteti i Auditimit.

## Çështja B10 – Funksonimi i AB-së dhe Komiteti i Auditimit

- Gjetja** Ekzistojnë dobësi në fushën e auditimit të brendshëm, kjo për faktin se:
- Fushëveprim i Auditimit të Brendshëm ishin kryesisht aktivitetet e vitit 2017, dhe pjesërisht ato të vitit 2018;
  - Plani vjetor i auditimit jo i bazuar në fushat më me rrezik. Nuk janë mbuluar sa duhet menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i buxhetit, menaxhimi i pasurisë, obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme;
  - Rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti. Sipas raportit vjetor të AB-së, nga 15 rekomandimet e dhëna, vetëm 3 nga to janë zbatuar, 7 ishin në proces të zbatimit dhe 5 të tjera nuk ishin zbatuar. Përveç kësaj, zyra e prokurimit nuk ishte përgatitur as plan veprimi për adresimin e rekomandimeve; dhe
  - Përbërja e komitetit të auditimit (KA) nuk ishte në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikën më të mira. Kryesuesi i KA për disa muaj me MSHV ishte i angazhuar në kryerjen e punëve në drejtorin për buxhet e financa, ndërsa më vonë ishte punësuar me kontratë të rregullt në pozitën udhëheqës i sektorit për punë profesionale në kuadër të DAP. Një anëtare tjetër e KA ishte angazhuar në detyra ekzekutive, duke qenë pjesë e komisionit punues për verifikimin e pronave komunale. Anëtarët e KA nuk duhet të jenë anëtar të ekipit ekzekutiv të organizatës.

**Rreziku** Fokusimi i AB-së në aktivitetet e vitit paraprake nuk siguron me kohë informacion të duhur menaxhmentit për funksionimin aktual të kontrolleve të brendshme. Mos adresimi i rekomandimeve do të rezultojë në vazhdimin e mangësive të identifikuara nga AB.

**Rekomandimi B10** Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor i AB-së të ketë për fokus fushat më me rrezik dhe të përfshijë kryesisht aktivitetet e vitit aktual. Të përgatiten plane veprimi dhe të adresohen me kohë rekomandimet e AB-së. KA të mos ketë në përbërje anëtar të ekipit ekzekutiv të komunës.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpallje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një

---

proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

#### **Çështja C4 - Mungesa e regjistrit të rrezikut dhe vlerësim jo objektiv i pyetësorit të vetvlerësimit**

**Gjetja** Procedura 4 e MFK-së përcakton që menaxhmenti është përgjegjës për të zhvilluar një proces formal të menaxhimit të riskut. Gjithashtu, kërkohet që menaxhmenti i Komunës për secilin vit kalendarik të plotësojë pyetësorin e vetvlerësimit të qeverisjes, kontrollit dhe menaxhimit financiar.

Komuna nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e riskut, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Ndonëse në vitin 2018 menaxhmenti ka ndërmarrë disa iniciativa ende nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe nuk përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxhmentit por edhe si mungesë e llogaridhënies nga drejtorit komunale tek menaxhmenti i lartë lidhur me procesin e menaxhimit të rrezikut, por edhe mungesës së njohurive brenda drejtorive për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për këtë proces.

Menaxhmenti ka përmbushur kërkesën ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e pyetësorit të vetvlerësimit vjetor të organizatës, megjithatë nuk ishte mjaft objektiv dhe vetëkritik në vetvlerësim. Disa aspekte të komponentëve të MFK-së ishin mbivlerësuar nga menaxhmenti.

**Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të dobësojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk do të adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike. Vlerësimet jo objektive të komponentëve të MFK-së krijojnë pasqyrë jo reale të gjendjes faktike.

**Rekomandimi C4** Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete në përgatitjen dhe finalizimin e regjistrit të rreziqeve si dhe të delegoj përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut në drejtorit dhe sektorët e administratës dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë. Vet-vlerësimi vjetor i komponentëve të MFK-së të jetë më objektiv dhe të reflektojë gjendjen aktuale të organizatës.

## Çështja A6 – Raportimet e Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Zyrtarit Çertifikues

**Gjetja** Sipas ligjit nr. 06/L-021 për KBFP, Neni 7, zyrtari kryesor financiar (ZKF) në nivelin kryesor të subjektit publik, është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhënës ndaj Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e PVF të subjektit publik. Gjithashtu, sipas LMFP, Neni 14, çdo OB, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë Zyrtarin Çertifikues (ZÇ), që emërohet dhe i raporton ZKA-së.

Menaxhmenti i komunës ka përcaktuar strukturën organizative, janë deleguar detyrat dhe përgjegjësit dhe menaxhohet përmes drejtorive komunale. Megjithatë, linjat aktuale të raportimit dhe llogaridhënies të ZKF-së dhe ZÇ-së dallojnë nga kërkesat e legjislacionit aktual. Kjo ngase Zyrtari Kryesor Financiar dhe Zyrtari Çertifikues raportojnë në drejtorinë për buxhet e financa e jo te ZKA.

**Rreziku** Mos krijimi i duhur i linjave të raportimit mund të krijon paqartësi rreth përgjegjësi dhe strukturë jo adekuate e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë linja adekuate të raportimit dhe llogaridhënies. Pozitat e ZKF-së dhe ZÇ të jenë në përputhje e kërkesat e LMFP dhe Ligjit të KBFP-së.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 për Komunën e Gjakovës ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tre (3) rekomandime janë zbatuar; katër (4) ishin në proces të zbatimit dhe dhjetë (10) rekomandime nuk janë adresuar ende si dhe dy (2) rekomandime ishin të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

N r.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet ndërmarra	Rekomandimi
1	Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.	Komuna nuk ka arrit të regjistrojë pronat komunale dhe një pjesë të blerjeve në SIMFK. Vlera e shpalosur e pasurisë nuk është e saktë.	Rekomandimi pa zbatuar
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.	Nuk janë ndërmarrë veprime. Mangësi të njëjta janë prezentë edhe në vitin 2018.	Rekomandimi pa zbatuar
3	Te hyrat	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.	Në harmoni me ligjin e ri të tatimit në pronë Komuna ka bërë inspektimin e 1/5 së pronave.	Rekomandimi zbatuar
4	Te hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se aplikuesit dorëzojnë dokumentacionin e plotë dhe të saktë në rastin e aplikimit për leje ndërtimore.	Janë ndërmarrë veprime për adresimin e rekomandimit.	Rekomandimi zbatuar
5	Te hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimin me kohë të të hyrave në SIMFK. Vëmendje ti kushtohet ruajtjes dhe menaxhimit të dokumentacionit.	Janë ndërmarrë veprime për adresimin e rekomandimit	Rekomandimi zbatuar

6	Personeli	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit dhe pagesave bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante. Në këtë aspekt duhet të forcohen kontrollet në proceset e rekrutimit në mënyrë që komisionet të bëjnë vlerësim objektiv në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Gjithashtu, kryetari duhet të ndërmarrë veprime shtesë për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me UD. Kohëzgjatja e funksionit si UD nuk duhet të jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.	Procedurat e rekrutimit janë përcjellë me parregullsi dhe ka edhe mangësi tjera përderisa çështja e ushtruesve të detyrës dhe kontratave për mësimdhënës ishin adresuar.	Rekomandi mi është në proces të zbatimit
7	Mallra e Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave. Çertifikimi i pagesave duhet të bëhet vetëm pasi lëndët të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2018 janë hasur parregullsi në pagesa.	Rekomandi m i pa zbatuar
8	Mallra e Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e masave/proceseve të duhura për të siguruar se kërkesat ligjore të prokurimit publik zbatohen në tërësi. Kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit të jenë matshme dhe të arritshme për kontraktuesit.	Edhe në vitin 2018 janë hasur mangësi në procedurat e prokurimit.	Rekomandi m i pa zbatuar
9	Mallra e Shërbime	Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes MSHV të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore	Nuk janë ndërmarrë veprime. Numri i punonjësve është rritur në 2018.	Rekomandi m i pa zbatuar
10	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të sigurohet buxheti i duhur për realizimin e tyre. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë rregullisht zbatimin e projekteve, dhe të hartojnë raporte në të cilat ofrohen informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit. Për çdo vonesë të paarsyetuar në realizimin e projekteve të aplikohen penalet.	Ende kemi kontrata të viteve të hershme por që numri i tyre është zvogëluar nga 6 në 5 dhe kemi progres te planet e menaxhimit të kontratave të cilat	Në proces të zbatimit



			tani janë bërë me kohë.	
11	Çështje të përbashkëta - M&SH dhe IK	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Në këtë aspekt, të bëhen analiza të detajuara lidhur me planifikimin e projekteve për të tejkaluar sfidat e identifikuar lidhur me afatet kohore për fillimin e procedurave dhe fondet e planifikuara për realizimin e tyre. Me tutje, të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPN-në, dhe me rregullat e Thesarit.	Janë evidentuar edhe këtë vit mangësi në planifikim dhe blerjet përmes procedurave të prokurimit.	I pa zbatuar
12	Çështje të përbashkëta - M&SH dhe IK	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe regjistrohen në kode përkatëse ekonomike.	Edhe këtë vit janë evidentuar keq klasifikime, madje në këtë vit kemi edhe keq klasifikim të hyrat nëpër kode ekonomike.	I pa zbatuar
13	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat ligjore për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë janë përmbushur. Komisioni punues të vazhdojë punën në identifikimin dhe vlerësimin e tërë pasurisë në pronësi të komunës, si dhe të gjitha pasuritë kapitale të evidentohen në regjistrin kontabël të Thesarit.	Pasuritë dhe pronat komunale nuk janë regjistruar plotësisht, dhe ende një numër i tyre mbeten të paregjistruara.	I pa zbatuar
14	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen në pajtim me rregullat dhe kërkesat ligjore. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë	Ky rekomandimi nuk është zbatuar dhe lidhet me rekomandimin B8.	I mbyllur i pazbatuar

		lidhur me kilometrat e kaluara, riparimet e bëra si dhe të dhëna tjera të nevojshme.		
15	Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar arkëtimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndërmarrë veprime. Vlera e LL/A është rritur në raport me vitin 2017.	I pa zbatuar
16	Obligimet e pa paguara	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokolojnë të gjitha faturat e pranuar, ndërsa me pas duhet të sigurohet se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e tyre.	Janë ndërmarrë veprime për evidentimin e faturave me numër të protokollimit. Vlera e borxheve ka trend të zvogëlimit.	Në proces të zbatimit
17	Procesi i zbatimit të rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve është zbatuar.	I mbyllur
18	Sistemi i Auditimit të Brendshëm.	Kryetari duhet të punojë me drejtorin e NjAB-së për të siguruar aktivitete të mjaftueshme mbi sistemet financiare të periudhave aktuale me fokus në fushat me rrezik më të lartë. Përmbushja e planit vjetor të NjAB-së duhet të monitorohet rregullisht nga menaxhmenti në mënyrë që devijimet të adresohen në kohën e duhur. Përveç plotësimit të NjAB-së me staf të mjaftueshëm, Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të KA-së.	Edhe në vitin 2018, janë përsërit mangësitë e njëjta.	I pa zbatuar
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe	Kryetari duhet të siguroj se ecuritë buxhetore, përfshirë planin e prokurimit dhe shpenzimet do të jenë subjekt i analizave dhe rishikimeve të rregullta nga	Janë ndërmarrë veprime, megjithatë nuk është arritur të	Në proces të zbatimit

	menaxhimi i rrezikut	ana e komunës. Për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	finalizohet regjistri i rrezikut.	
N r.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasqyrat Vjetore Financiare - Ref. B1	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Kjo kërkon veprime specifike për të confirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë adresuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronave përfshirë edhe rishikimin e PFV-ve të vitit 2019 nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Ref B2	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.		
3	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Ref B3	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë në mënyrë që shpenzimet dhe të hyrat të klasifikohen drejtë në përputhje me kodet përkatëse ekonomike të përcaktuara me planin kontabël të Thesarit/SIMFK.		
4	Të Hyrat Ref A1	Kryetari duhet të sigurojë monitorim përmes menaxherit të financave për të siguruar se në fund të ditës të gjitha paratë e gatshme të arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve komunale deponohen në llogarinë bankare.		
5	Paga e Mëditje Ref C1	Kryetari duhet të sigurojë se proceset e rekrutimit janë duke u zhvilluar në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit. Komisionet përzgjedhëse duhet të jenë profesionale dhe të dokumentojnë si duhet të gjitha fazat e procesit të rekrutimit.		
6	Paga e Mëditje Ref B4	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të thjeshtuara të rekrutimit për punët që konsiderohen të realizohen përmes MSHV-ve. Nevojat për pozitën të rregullta të punës të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor, e jo të aplikohen MSHV. Kjo formë e angazhimit të kontraktuesve të aplikohet vetëm në rastet urgjente, dhe kur kërkesat të jenë të arsyetuara nga njësitë		

		kërkuese. Pagesat për shërbimet e tilla nuk duhet të tejkalojnë vlerën e kontraktuar.
7	Paga e Mëditje Ref A2	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e personelit i përmbahet kërkesave të vendimit të qeverisë për dëshmitë që të punësuarit duhet të ofrojnë për të përfituar shtesën në pagë për përvojën e punës. Ndalesat në paga dhe kompensimet të kalkulohen saktë dhe të realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.
8	Mallra e Shërbime Ref B5	Kryetari duhet të sigurojë kontrollin shtesë në çertifikimin e pagesave. Vetëm lëndët që janë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm të procesohen për pagesë.
9	Subvencione e Transfere Ref A3	Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e granteve plotësojnë në tërësi kushtet e marrëveshjeve për financim. Po ashtu, duhet të sigurohen format e përshtatshme të ndalesave në emër të sigurisë apo garancionit të punimeve. Nëse OE nuk i përmbahet kushteve kontraktuale, Komuna të vlerësojë si mundësi ndalesën e sigurisë së ekzekutimit të kontratës ose mos pagesën e situacionit të fundit të punimeve.
10	Investimet Kapitale Ref C2	Kryetari duhet të trajtoj me prioritet dhe të analizojë mundësitë buxhetore në implementimin e këtyre kontratave në afatin më optimal të mundshëm. Po ashtu, komisionet e vlerësimit të tenderëve duhet të vlerësojnë drejtë kriteret dhe analizojnë mirë dëshmitë e ofruara nga ofertuesit dhe OE që nuk janë në përshtatshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit të mos shpërblehen me kontratë.
11	Investimet Kapitale Ref A4	Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale planifikohen drejtë në aspektin buxhetor dhe në afatin kohor të arsyeshëm të implementimit të kontratës. Hyrja në obligime kontraktuale të bëhet vetëm pasi të jenë siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Menaxherët e kontratave të ofrojnë informata të mjaftueshme dhe relevante lidhur me procesin e implementimit të projekteve kapitale. Planet e menaxhimit të kontratave të përmbajnë informata të nevojshme lidhur me afatet, pagesat, implementimin dhe përfundimin e kontratave.
12	Investimet Kapitale Ref A5	Kryetari duhet të përforcojë mekanizmat e kontrollit në menaxhimin dhe monitorimin e kontratave. Menaxherët e kontratave nuk duhet të pranojnë punët/ furnizimet e pa përfunduara.

13	Çështjet e përbashkëta - Ref B6	Kryetari duhet të sigurojë që të mos hyjë në obligime kontraktuale dhe financiare pa sigurim paraprak të mjeteve buxhetore, si dhe të forcojë disiplinën financiare në pagesën e obligimeve me kohë dhe evitimin e shpenzimeve shtesë.
14	Çështjet e përbashkëta Ref B7	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet kontraktuale dhe financiare të mos krijohen pa u zotuar paraprakisht mjetet e duhura financiare në SIMFK. Urdhër blerjet e përgatitura dhe të nënshkuara duhet ti paraprijnë procesit të furnizimit apo realizimit të punimeve.
15	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale Ref B8	Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ligjore për menaxhim dhe regjistrim të pasurisë. Përmes programit e-pasuria të aplikohet kalkulimi i zhvlerësimit për pasuritë jo kapitale. Procesi i inventarizimit të pasurisë të përfundojë para përgatitjes së PVF, me qëllim që ndryshimet e identifikuara përmes inventarizimit të reflektojnë në shpalosjen e drejtë të pasurisë.
16	Të arkëtueshmet - Ref B9	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, zyra e financave të mbajë një regjistër të konsoliduar dhe të plotë të ngarkesave dhe pagesave mujore përgjatë viteve për shfrytëzuesit e pronave komunale.
17	Obligimet e pa paguara - Ref C3	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet krijohen vetëm pasi të jenë zotuar paraprakisht mjetet financiare në SIMFK. Pagesa e obligimeve të bëhet brenda 30 ditësh nga pranimi i faturës.
18	Sistemi i Auditimit të Brendshëm- Ref B10	Kryetari duhet të sigurojë se plani vjetor i AB-së të ketë për fokus fushat më me rrezik dhe të përfshijë kryesisht aktivitetet e vitit aktual. Të përgatiten plane veprimi dhe të adresohen me kohë rekomandimet e AB-së. KA të mos ketë në përbërje anëtar të ekipit ekzekutiv të komunës.
19	Qeverisja e mirë Ref C4	Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete në përgatitjen dhe finalizimin e regjistrimit të rreziqeve si dhe të delegoj përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut në drejtorit dhe sektorët e administratës dhe të sigurojë raportim të rregullt për zbatimin e kërkesave në këtë fushë. Vet-vlerësimi vjetor i komponentëve të MFK-së të jetë më objektiv dhe të reflektoj gjendjen aktuale të organizatës.
20	Qeverisja e mirë Ref A6	Kryetari duhet të sigurojë linja adekuate të raportimit dhe llogaridhënies. Pozitat e ZKF-së dhe ZÇ të jenë në përputhje e kërkesat e LMFPF dhe Ligjit të KBFP-së.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes
- që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



## Shtojca II: Letër e Konfirmimit



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

Data: 20 Qershor 2019, Gjakovë

